



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:146765
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05761378

CAP.nr.856/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, në çështjen përbarimore të kreditores V.S nga Prishtina, të cilën e përfaqëson i autorizuari av.S.K nga Prishtina, kundër debitorit SHSKUK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës - QKUK, me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit në emër të shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditores të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.2373/2020, të datës 12.10.2023, me datën 30.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditores V.S nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.2373/2020, i datës 12.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.2373/2020, të datës 12.10.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit SHSKUK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës - QKUK, me seli në Prishtinë dhe e ka shfuqizuar urdhrin përbarimor P.nr.1965/20, të datës 28.05.2020, të lëshuar nga përbaruesi privat A.M, me seli në Prishtinë. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktvendimit ka anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra në çështjen përbarimore.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditorja përmes të autorizuarit të saj ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës

materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditores dhe të priset aktvendimi PPP.nr.2373/2020, i datës 12.10.2023, të lihet në fuqi urdhëri përmbartimor P.nr.1965/20, i datës 28.05.2020, ashtu që të detyrohet debitori SHSKUK - QKUK në Prishtinë, që në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj kreditorit shumën e cekur si në propozim me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e parashtrimit të propozimit për përmbartim gjer në pagimin definitiv, si dhe shpenzimet procedurale të cekura si në ankesë.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditores.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- ankesa e kreditores, **është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja me datë 28.05.2020, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të titullit ekzekutiv, vendimit të Inspektoratit të Punës nr ..., të datës 10.02.2020, dhe vendimi nr ... i datës 18.11.2020, më gjerësisht si në propozimin për përmbartim. Përmbartuesi Privat A.M ka nxjerr urdhrin P.nr.1537/20, të datës 28.05.2020, me të cilin e ka lejuar propozimin për përmbartim. Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit debitori me datë 12.06.2020, ka paraqitur prapësim me të cilin ka kërkuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe urdhri P.nr.1965/20, i datës 28.05.2020, të anulohet, dhe propozimi për përmbartim të hedhet poshtë si i pa bazë. Kreditori me datë 17.09.2020, ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.2373/2020, të datës 12.10.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit duke vendosur sikurse në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se propozimi i kreditores për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartues, vendimit të inspektoratit të punës nr ..., i datës 10.02.2020, nuk është i përshtatshëm për përmbartim. Tutje ka theksuar se në rastin konkret vendimi i sipërcekur, respektivisht në dispozitiv të të njëjtit nuk është specifikuar shuma e përmbushjes së detyrimit, ashtu që gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se përmbartuesi privat në kundërshtim me ligjin ka lëshuar urdhrin për përmbartim dhe se i njëjti është dashur që së pari të vlerësoj nëse dokumenti përmbartues, është bazuar në propozim për përmbartim dhe se a i plotëson kushtet. Gjithashtu ka arsyetuar edhe lidhur me vendimin nr..., të datës 18.11.2020, për korrigjimin e gabimeve në vendimin nr ..., të datës 10.02.2020, duke potencuar se titull përmbartues është ai dokument mbi bazën e të cilit inicohet procedura e përmbartimit dhe realizohet kërkesa e përmbartur në të. Ashtu që kjo gjykatë ka konsideruar se me asnjë veprim të mëvonshëm, nuk mund të zëvendësohet titulli përmbartues mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura e përmbartimit. Për mënyrën e vendosjes e njëjta i është referuar dispozitës së nenit 24, 27, 71 dhe 73 të LPP.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit se Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) k) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditores, Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbartimor, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbartim, konform dispozitave ligjore në fuqi. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret dokumenti përmbartimor është i papërshtatshëm për përmbartim edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbartimor është i përshatshëm për përmbartim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shiqim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbartimor – vendimi administrativ i inspektoriatit të punës nr ..., i datës 10.02.2020, në dispozitiv të tij nuk e përmban shumën e detyrimit, e që nuk dihet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qëndrojnë pretendimet e prapësimit të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbartueshmërisë së dokumentit përmbartimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, andaj për Gjykatën e Apelit gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e palës kreditore, mirëpo të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për shkak se me shikim në shkresat e lëndës vërtetohet se me rastin e parashtrimit dhe lejimit të propozimit për përmbartim i njëjti është lejuar në bazë të vendimit nr ..., të datës 10.02.2020, i cili nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i rregullt përmbartimor, për çka fakti se tani është bërë korrigjimi i këtij vendimi nuk ndikon në ndryshimin e vendimit.

Duke i vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se pala kreditore as gjatë procedurës e as me ankesë nuk ka propozuar plotësimin e propozimit përmbartimor, por vetëm me akt përcjellës ka bashkangjitur korrigjimin e vendimit, andaj dhe gjykata e shkallës së parë sipas prapësimit së debitorit ka qenë e detyruar që të veprojë konform dispozitave ligjore dhe me të drejtë ka vendosur, pasi që ka qenë detyrim i vetë palës kreditore e cila ka interes në këtë procedurë, që paraprakisht të bëjë edhe precizimin dhe korrigjimin e propozimit për përmbartim. Gjykata e Apelit vlerëson se pala kreditore eventualisht mund të parashtrrojë propozim të ri në bazë të vendimit i cili i plotëson kushtet për tu konsideruar

dokument i rregullt përmbartimor, pasi që në këtë procedurë ka bërë lëshime të cilat e kanë pamundësuar përmbartimin e propozuar.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *"në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual"*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.856/2024, me datën 30.05.2024

Kryetari i Gjykatës
Valon Totaj